

FJALA E DEPUTETIT MILVA EKONOMI

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, unë e mendoj gjithmonë që të dalësh përpara kësaj foltoreje është një përgjegjësi e madhe, pasi fjala merr një peshë të konsiderueshme, sepse përpara kësaj foltoreje diskutohet për ligje të rëndësishme, diskutohet për projekte madhore, diskutohet për gjëra që u ndryshojnë jetën qytetarëve, por natyrisht analizohen edhe situata të cilat nuk shkojnë shumë mirë, ku ne deputetët, të gjithë, me transparencë dhe përgjegjësi duhet të bëhemi gati për t'i ndarë këto ide me të gjithë të interesuarit. Në fakt, roli i kësaj foltoreje sot nuk ishte ky. Roli i kësaj foltoreje u dominua nga retorika më absurde që kemi dëgjuar ndonjëherë tjetër, ku vumë re që kolegët e opozitës folën me informacione jo kronologjike këtu. Vërtet u morën me çështjen “McGonigal”, por, a e keni ndjekur diskutimin që ka bërë Departamenti i Shtetit këto kohë? A e dëgjuat deklaratën publike të zotit Eskobar në datën 28 shkurt? Kur gazetarja e “News 24” dhe e “Zëri i Amerikës” i bëri pyetjen se çfarë mendonte për situatën në Shqipëri, ai u përgjigj: “Kjo është një çështje që i takon FBI-së”. U përgjigj shumë saktë dhe vazhdoi të thoshte: “Për ne Shqipëria është një partner i rëndësishëm strategjik. Ne, bashkë me Shqipërinë, kemi dhënë produkte të mira në Këshillin e Sigurimit dhe Shqipëria e ka përqafuar politikën në NATO më së miri. Çështja “McGonigal” nuk ka asnjë lidhje me politikën e bashkëpunimit të mirë që ne kemi me Shqipërinë”. Po të hyni në faqen e web-it të Department of State do ta lexoni këtë përgjigje. Zonja që i bëri pyetjen është një gazetare shqiptare, kështu që, ju lutem shumë, kur vijmë këtu, herë pas here të informohemi për gjënë në mënyrë më të plotë, më holistike të mundur.

Nga ana tjetër, ne të gjithë këtu jemi dëshmitarë të asaj që po ndodh brenda jush, pasi ju jeni të përçarë dhe nuk dini se kush është ai që drejton, kush është ai që bën aksionin dhe të gjithë mjegullnajën e kësaj farse kërkoni ta hidhni mbi ne. Në fakt, duke dashur të bëni diçka tjetër, duke dashur të harroni, ju nuk mund ta akuzoni Kryeministrin e vendit edhe për një fakt tjetër. E dini ju që kur qeveria “Rama 1” u formua, në datën 15 shtator të vitit 2013, një nga vendimet që mori ishte pikërisht edhe Kodi Etik i Ministrave? Kodi Etik i Ministrave është një dokument zyrtar, i cili e rriti transparencën e qeverisë në një nivel tjetër. Sot ne kemi një Kryeministër dhe ministra që transparencën e kanë kryefjalën e punës së tyre. Unë për këtë besoj shumë fort, pasi Kryeministri është nga ata që debatin e ka bërë në formë të hapur. Ai ka bërë kudo që është e mundur një vlerësim shumë pozitiv për Shqipërinë dhe nuk ka pasur asnjëherë ndonjë ngërç për të treguar atë që është realisht vendi ynë, i vogël, me probleme, me nevojë për mbështetje dhe me nevojë për të çuar përpara reforma të mëdha. Unë besoj se kjo që kërkoni ju është si fantazi filmash. Në fakt, është një Charlz në Amerikë, i cili do të fusë në krimet e tij Kryeministrin e Shqipërisë dhe me këto që po bën, do të japë disa informacione që nuk janë aq shumë të vërteta.

Në fakt, gjatë gjithë ditës ju dëgjuat atë që prokuroria amerikane kishte bërë në aktakuzë. Vetë Kryeministri e demonstroi se të 14 herët e përmendjes së emrit të tij, kishin një gjë të vërtetë që lidhet me parimin e transparencës që udhëheq këtë qeveri. Çështja “McGonigal” nuk ka lidhje me shtetin shqiptar, nuk ka lidhje as me Kryeministrin. Dosja hetimore ka shkuar në gjyq dhe prokuroria amerikane ka ngritur akuzën vetëm për një person, i cili është Charlz McGonigal. Ky fakt, gjithashtu,

mbas deklaratës së Eskobarit ngre në vëmendje edhe një gjë tjetër që është shumë e rëndësishme, ndan plotësisht atë që është e vërteta nga gënjeshtria. Gënjeshtria është që thuhet se midis këtyre dy vendeve nuk ka marrëdhënie të mira. Kjo nuk është fare e vërtetë. Eskobari e theksoi me gojën e tij që marrëdhëniet me Shqipërinë nuk kanë qenë ndonjëherë më të mira. Pra, në qoftë se ju do të merreni me njëritjetrin të zgjidhni se kush është ai që do të drejtojë, kush do të marrë përsipër të bëjë opozitën e vërtetë, ne nuk do të kemi kohë të jetojmë me këto gënjeshtria ditëshkurtra dhe me këto farsa që nuk na çojnë asgjëkund. Unë besoj se është e padiskutueshme që duhet të vini këtu përpara si një forcë opozitare që ka ide, që orientohet dhe që i fokuson të gjitha energjitë drejt zhvillimit më të mirë të vendit, sepse nuk mund të kemi fantazi të tjera të shfrenuara dhe absurde, pasi të gjithë së bashku duhet të shkojmë drejt një përjetimi tjetër. Shqipëria ka filluar një rrugë zhvillimi, që është rruga e anëtarësimit në Bashkimin Europian, e cila kërkon shumë mund dhe shumë punë. Është i patjetërsueshëm fakti që në aktakuzën e drejtësisë amerikane nuk ka asnjë akuzë për ndonjë shtetas shqiptar dhe aq më tepër për Kryeministrin Rama. Gjithashtu, në përfundim të hetimeve FBI-ja, ka ngritur vetëm një akuzë, vetëm për McGonigal, i cili ka bërë deklaratime të rreme lidhur me udhëtimet dhe takimet e tij në Europë. Në fakt, një nga gjërat e rëndësishme që thuhet atje është diçka që mund të lidhet me favorizimet që mund të jenë kryer ndaj personave të përmendur në aktakuzë nga ana e qeverisë dhe e Kryeministrit, por në asnjë moment, qeveria nuk ka ndërmarrë veprime për të mbështetur interesat e individëve të përmendur. Takimet e kryeministrit me McGonigal-in nuk kanë pasur asnjëherë në fokus interesat personale të ndonjë shtetasi, por ata janë fokusuar në biseda të përgjithshme mbi influencën në rajon. Në fakt, ne po përpiqemi të kuptojmë se çfarë do të faktohet për ju në këtë influencë. Ka vite tashmë që flitet në të gjitha mediet, se dosja e lobimit e PD-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me paratë ruse është atje. Natyrisht, shqiptarët nuk mund të harrojnë se paratë ruse, të cilat edhe raporti i CIA-s i përmend disa herë, janë renditur në klubin e të paguarve nga Rusia bashkë me disa parti të tjera të rajonit, parti që njihen si parti proruse dhe parti antishqiptare, në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi apo edhe në Bosnje Hercegovinë. Shqiptarët nuk mund të harrojnë asnjëherë se “21 janari” nuk është çështje e Partisë Socialiste dhe e Kryeministrit Rama. Ata nuk i vranë protestuesit në bulevard. Shqiptarët nuk mund të harrojnë asnjëherë se Gërdeci u hodh në erë për t’u shitur amerikanëve fishekë kinezë. Ata e dinë që këtë gjë nuk e bëri Partia Socialiste dhe Kryeministri Edi Rama. Shqiptarët nuk mund të harrojnë asnjëherë që ju e katandisët Shqipërinë në vendin që nuk e vizitonte asnjë kryeministër dhe nuk e thërriste askush kryeministrin për vizita. Për këto arsye, disa nga ju, ata që ju udhëheqin, janë shpallur si personazhe non grata nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Britania, madje as nuk thirren në forumet europiane që bëjnë forcat e të njëjtit krah politik në Europë. Prandaj të mos vazhdojmë me pallavra dhe përralla që Edi Rama dhe qeveria socialiste e kanë izoluar Shqipërinë nga bota dhe lidhen, bashkëpunojnë dhe mbahen falë mafias kombëtare dhe ndërkombëtare, sepse ngjarjet janë shumë ndryshe dhe kokëforta.

Të gjithë ishim këtu në Tiranë më 6 dhjetor 2022, kur u zhvillua për herë të parë Samiti i Bashkimit Europian me Ballkanin Perëndimor, i cili u bë ngjarja më e spikatur në politikën e Shqipërisë, si dhe tregoi frymën e lartë të bashkëpunimit të integritetit që Shqipëria ka me partnerët e saj ndërkombëtarë. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se në këto momente, në këtë pozicion që kemi dhe pikërisht për këtë përgjegjësi që na jep kjo foltore, ne jemi këtu për të bërë më të mirën për qytetarët. Ne jemi këtu për të bërë punë të mëdha dhe për t’u ndryshuar qytetarëve jetën e përditshme. Prandaj unë besoj fort se kjo do të jetë një nga gjërat për të cilën ne duhet të punojmë bashkë. Ndërkohë, ju duhet të keni parasysh edhe faktin tjetër, që dje, Departamenti Amerikan i Shtetit i hodhi poshtë akuzat që Sali Berisha bënte kundër zyrtarëve amerikanë për gjobëvënie, si akuza qesharake, duke e njohur veten si një nga departamentet më të forta në historinë e botës për luftën kundër korrupsionit. E gjithë kjo furtunë që ngrihet është shumë qesharake dhe bëhet për të prishur imazhin e Shqipërisë

në botë. Ju nuk e arrini dot këtë gjë, pavarësisht nga gjërat që thoni, sepse Shqipëria është ai vend që fqinjësinë e mirë e ka kryefjalë sot. Shqipëria është ai vend që politikën e mirë me NATO-n e ka kryefjalë. Populli shqiptar do që këto gjëra të mira t'i ndodhin në jetën e përditshme. Prandaj, 14 maji do të jetë një sfidë e madhe për ju, në qoftë nuk ndryshoni retorikën dhe nuk shkoni drejt politikave të zhvillimit dhe politikave të qëndrueshme për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen në territorin e vendit. Faleminderit!